



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.303/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.303/2025, e parashtruar nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 01 Shkurt 2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ku pretendohet se Ermira Meha dhe Besarta Meha Ademi, kanë publikuar ne rrjetin social facebook, fotografi të tubimit të mbajtur nga kandidatja për deputete nga subjekti politik PDK, Sala Jashari, në fshatin Vojnik të Skenderajt, ku pjesëmarrës në këtë tubim ishin edhe fëmijët nën moshën 15 vjeçare.

Më tutje në ankesë pretendohet se subjekti politik PDK, me këto veprime ka konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, siç përcaktohet me nenin 5. par.3 të Rregullores Zgjedhore 07/2024. Po ashtu në ankesë pretendohet se me përdorimin e fëmijëve të mitur nën moshën 15 vjeçare, janë cenuar rëndë dispozitat e lartcekura, andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura si dhe bazuar në praktikën e deritanishme të PZAP-it, mes tjerash me vendimin Anr.212/2025, kërkohet që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur linqet ku pretendohet pjesëmarrja e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, dhe likqet;

<https://www.facebook.com/ph0to?fbid=1028383465975822&set=pcb.1028389215975247>
<https://www.facebook.com/ph0t0?fbid=1028383479309154&set=pcb.1028389215975247>

PZAP me datë 02 Shkurt 2025 iu drejtua për përgjigje në ankesë subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës.

Në përgjigjen e PDK-së, lidhur me pretendimet e LVV, se në tubimin e mbajtur nga Kandidatja për deputete nga subjekti politik PDK, Sala Jashari, në fshatin Vojnik të Skenderajt, ku pjesëmarrës në këtë tubim ishin edhe fëmijët nën moshën 15 vjeçare pa prezencën dhe rrjedhimisht, pa pëlqimin e prindërve dhe kjo përbën shkeljen e dispozitave përkatëse të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2025, konkretisht nenit 5, paragrafit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, theksojnë se është i paqëndrueshëm sepse nga provat vërehet se nuk është e ndërlidhur me angazhimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në fushat, rrjedhimisht subjekti i tyre nuk ka angazhuar fëmijë në fushatë. Takimi është realizuar në ambientet e brendshme të familjes, konkretisht në shtëpinë e znj. Ermira Meha e cila ka realizuar pritje nderi për kandidaten znj. Sala Jashari për deputete të Kuvendit të Kosovës për Zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Po ashtu, PDK në përgjigje e tyre, në mënyrë të pa kontestueshme e pohojnë prezencën e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare, por s'ka se si të mos jenë nën përcjelljen e prindërve kur kjo ka ndodhur në shtëpinë e tyre dhe se ankuesi nuk ka asnjë prove se prezenca e fëmijëve të mitur është bërë pa pëlqimin e prindërve të tyre, andaj ka kërkuar që PZAP-i, të marrë vendim lidhur me refuzimin e ankesës.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik PDK respektivisht kandidatja për deputete Sala Jashari, nuk ka bërë shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se: *Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.* Mbi bazën e provave me saktësisht nga fotot dhe linku vërtetohet se për kandidaten për deputete është organizuar një pritje në një ambient shtëpie, me qrast vërtetohet se prezent aty është edhe një fëmijë, mirëpo është afër personave madhor e që nuk mund të përjashtohet mundësia se fëmija është në prezencën e prindit e në ambientet e shtëpisë së tij andaj nuk ka dyshim se ky fëmijë është apo imazhi i këtij fëmije të jete përdorur për fushatë.

Ndërsa neni 117 par. 3 LZP, ka parapare se vendosja për ankesat PZAP-ja mbështet në prova të qarta dhe bindëse. Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në ankesë.


Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe e paprovuar andaj si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore,

Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.303/2025 datë 04.02.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.